# DËSHMI ARKIVI

**A-437940**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | EMRI/ Ky është i burgosuri shqiptar që u arratis në Greqi, u ndihmua nga dy persona të kamufluar si policë \| |
| ADRESA | `https://boldnews.al/2026/09/12/u-arratis-ne-menyre-spektakolare-ky-eshte-i-burgosuri-shqiptar-ne-greqi-u-ndihmua-nga-dy-persona-te-kamufluar-si-police/` |
| BURIMI | boldnews.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 12 shtator 2026, 08:20:36 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 12 shtator 2026, 08:18:51 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | b59c1cd1a8fcca9127948828341ce1d56a5cb0db294c1ecf4ba05378c10c389c |
| TEKSTI | 8278d3d19c711213e1afafe1c1d63a3787a93210b330a03c21e0d1d68f5ec5a8 |
| PAMJA | e4f569afeeab4e0f5631111471337825518 9f62973af325b5a456fa6941a688f |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | 878dca29116458e2d6a1acf5922f4a209e83cb945893346f4c6b3fe8ea22a4eb |
| E MËPARSHMJA | c5c9efc9a796657d209c39380d67c5564a42cf6dc618e595b4a8761291715d0e |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/878dca29116458e2d6a1acf5922f4a209e83cb945893346f4c6b3fe8ea22a4eb`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# EMRI/ Ky është i burgosuri shqiptar që u arratis në Greqi, u ndihmua nga dy persona të kamufluar si policë

10:18 : 12/09/2026

në AKTUALITET, KRONIKE, RAJONI

- Botërori 2026
- PRIVACY POLICY
- KONTAKT
- EKONOMI
- SHENDETI
- SHOW BIZ
- KULTURE
- POLITIKE
- KRONIKE
- TEKNOLOGJI
- VIDEOT KRYESORE TE DITES
- VIDEO
- BOLD BLOG
- FOTOGRAFI
- HOROSKOPI
- NDRYSHE

- RAJONI
- BOTA
- SOCIALE

**Gentian Çipi** është 41-vjeçari shqiptar, i cili u arratis në mënyrë spektakolare gjatë transferimit nga burgu i Serresit në spital.

Sipas informacioneve të publikuara nga mediat greke ngjarja ka ndodhur rreth orës 23:30, ku automjeti i transportit ndodhej në ambientet e jashtme të spitalit, pranë repartit psikiatrik. Në automjet ndodheshin i burgosuri dhe dy punonjës që e shoqëronin.

Në atë moment, pranë automjetit janë shfaqur dy makina, të ngjashme me automjetet e policisë. Personat që ndodheshin në to janë afruar drejt mjetit të transportit dhe, nën kërcënimin e armëve, kanë neutralizuar dy shoqëruesit.

Më pas, autorët kanë ndihmuar të burgosurin të largohej. Sipas informacioneve, ata kanë marrë me vete edhe armën e shërbimit të një punonjësi të burgut. Pas kësaj, grupi është larguar me dy automjetet dhe ka humbur gjurmët.

I arratisuri është një shtetas shqiptar 41-vjeçar, i cili, sipas mediave greke, ishte arrestuar vitin e kaluar nga strukturat e Krimit të Organizuar për një çështje që lidhej me tentativë vrasjeje në Selanik.

**Lexo edhe:**

Arratisje spektakolare në Greqi, i burgosuri shqiptar i ikën policisë gjatë transportit për në spital!

Operacioni misterioz në Greqi/ Kush është trafikanti i kokainës që u arrestua dhe kërkohej nga Shqipëria për vrasje

Ngjarja kishte ndodhur në një kioskë ushqimore. Ai dyshohet gjithashtu se ka pasur përfshirje në çështje të lidhura me armët dhe trafikun e narkotikëve.

**Kush është Gentian Çipi?**

Çipi rezulton një person me precendet të rëndë penalë në Shqipëri e në Greqi. Konkretisht ai rezulton i dënuar në Shqipëri në korrik 2024 me 2 vjet burgim për "shkatërrim i pronës me zjarr" e kryer në bashkëpunim dhe në rrethana rënduese.

Fillimisht ai ishte hetuar në masën "Arrest në burg" por më pas Gjykata e kishte zbutur masën në "Ndalimi i daljes jashtë shtetit" dhe "Garancia pasurore".

Ai është akuzuar për djegien e një automjeti në 24.04.2023, në lagjen 13, Rr. "Loni Grazhdani" në Korçë.

Më herët, në janar 2023, në kuadër të operacionit "Fijet", policia procedoi Gentian Cipin për shkak se gjeti të vendosura kamera në mënyrë të paligjshme pranë banesës së tij.

Në 3 shtator 2024, Gentian Çipi hapi zjarr në Pylaia të Selanikut, duke tentuar të vrasë një 25-vjecar grek jashtë një kantine. Greku u plagos me 3 plumba por arriti t'i mbijetojë plagëve, ndërsa Cipi arriti të arratisej.

Policia greke arriti ta identifikojë Çipin dhe organizoi operacion për kapjen e tij në shtator 2025. Gjatë operacionit u arrestuan edhe Enea Basholli 31 vjec dhe Kleo Topa 24 vjec, edhe këta nga Korça. Sipas policisë greke, Gentian Cipi, rezulton kreu i një grupi kriminal që kryen trafik droge dhe veprime të dhunshme.

Gjatë operacionit për kapjen e tyre në Selanik, Çipi dhe Topa, nuk i janë bindur urdhrit të policisë, por kanë shtuar shpejtësinë e mjetit me të cilin lëviznin dhe kanë kryer manovra të rrezikshme duke përplasur një automjet të policisë. Ata kanë braktisur mjetin dhe janë larguar në këmbë, por janë kapur më pas. Pak orë më vonë, në zonën e Halkidikisë, ka rënë në pranga edhe Enea Basholli.

Gjatë kontrolleve të policisë greke, janë gjetur dhe sekuestruar 1 Kallashnikov me 30 fishekë, 3 pistoleta, silenciator, rreth 31 kg marijuanë, pasaportë false, patentë false, 23 mijë e 350 euro, celularë dhe 3 automjete.

Etiketa: arratisjeGreqishqiptar

**Lajme të lidhura**

Arratisje spektakolare në Greqi, i burgosuri shqiptar i ikën policisë gjatë transportit për në spital!

08:54 : 12/09/2026

Operacioni misterioz në Greqi/ Kush është trafikanti i kokainës që u arrestua dhe kërkohej nga Shqipëria për vrasje

19:45 : 11/09/2026

[Vdekja e këngëtarit Giorgos Mazonakis/ Arrestohen dy mjekët e klinikës greke, dyshimet]

15:24 : 11/09/2026

[Greqia raporton 324 raste të virusit të Nilit Perëndimor]

11:53 : 11/09/2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.